



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 75 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 28/ 06 / 2024

VENDIM

Nr.16, date 28 /06/2024

PËR

**PROBLEMATIKAT NË LIDHJE ME SHFRYTËZIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN, MONITORIMIN DHE SIGURINË E DIGËS SË FANGUT DHE
RAPORTIT VJETOR PËR VITIN 2023 TË SHFRYTËZUESIT TË SAJ**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 28.06.2024 mori në shqyrtim raportin vjetor për vitin 2023 në lidhje me shfrytëzimin, operimin, monitorimin dhe sigurinë e digës së HEC Fangut që shfrytëzohet nga kompania AYEN shpk. Duhet theksuar se ky Raport i përgatitur nga kompania AYEN shpk është dorëzuar pranë KKDM në Qershor 2024 në një kohë që sipas legjislacionit në fuqi, raportet vjetore për gjëndjen dhe monitorimin e digës duhet të dorëzohen brenda muajit Mars të vitit pasardhës.

Nga Shqyrtimi i raportit vjetor për gjëndjen e digës së HEC Fangut, rezulton se informacioni në lidhje me gjëndjen e digës dhe monitorimin e saj është jo i plotë, i pa mbështetur me të dhëna të monitorimit të digës sidomos në lidhje me filtrimet në digë apo matjet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi (VKM Nr. 147, datë 18.03.2004, neni 31 dhe 32) dhe kërkesat e KKDM të shprehura në shkresat e dërguara pranë kësaj firme.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i Raportit Vjetor rezulton se kompania nuk ka dhënë asnjë informacion në lidhje me plotësimin e kërkesave të grupit të punës pas kontrollit 5 vjecar të KKDM të shprehura në Vendimin Nr. 45, datë 27.12.2023.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

- 1- Ti kërkohet kompanisë AYEN shpk të përgatit dhe të dorëzoj brenda muajit Shtator 2024 një raport të detajuar në lidhje me gjëndjen aktuale, monitorimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digës së HEC Fangut në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të KKDM të shprehura në shkresat përkatëse për përgatitjen e raportit vjetor. Në këtë raport, duhet të përshihet edhe informacioni i kërkuar për masat që janë marrë për plotësimin e kërkesave të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 45, datë 27.12.2023 në lidhje me rekomandimet e dhëna nga grup i punës që ushtroi kontrollin 5 vjecar në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

digën e HEC Fangut. Raporti i detajuar duhet të përgatitet dhe të dorëzohet pranë KKDM brenda Muajit Shtator 2024. Në rast të mosdorëzimit të këtij Raporti brenda muajit Shtator 2024, ti kërkohet MIE zbatimin e masave të kërkuara në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", neni 11 - Sanksione për mosplotësim të kërkesave të nenit 9 të këtij ligji.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI